

Visar
Zhiti

BIBLIOTEKA

854-1

74 74

MBJELLJA
E VETËTIMAVE



8JH-1
24 74

Visar ZHITI

MBJELLJA E VETËTIMAVE

Biblioteka VALËT

*Redaktor
Resul SHABANI*

*Recensues
Zija ÇELA*

*Ballinën
Dimçe ISAILLOVSKI*

*Përkujdesja
artistike-teknike
Mustafa GAVAZI*

Visar ZHITI

MBJELLJA E VETËTIMAVE



„Flaka e vëllazërimit“
– Redaksia e Botimeve –
Shkup, 1994

CIP – Narodna i univerzitetska biblioteka
„Kliment Ohridski“, Skopje

891.983 - 1

ZHITI, Visar

Mbjellja e vetëtimave / Visar Zhiti. –
Shkup : Flaka e vëllazërimit, 1994. – 96 fq. ;
20 cm. – (Biblioteka Valët)

Tirazhi 1000

Shënime për autorin: fq. 94.

ISBN 9989 – 658 – 06 – 4

* * *

*Gjithmonë jam me të mundurit,
me përpjekjet e tyre*

(që afrojnë dritë).

*Jam me ta deri në çastin e fitores,
pastaj iki, i braktis
dhe bashkohem*

me të mundur të tjerë.

*... kur kurorëzohet ndonjë fitore,
ndahem dhe me veten*

për të nisur betejën të reja...

Vetëm fitoret

që s'kanë të mundur,

dua!

*FANTAZMË
NË NJË
REPUBLIKË
TË
RE*

* * *

*Krahu i kuq i postbllokut
u ngrit lart
si një vetëtimë
që zgjohet nga plagët.*

*Ne hymë në borën
e një Republike të re.
Kërcënohet të përgjaket
kjo borë*

*si çarçafët e spitaleve
pas një kryengritje rrugësh.*

Dimër, 1993

NJË URË MBI VARDAR

*Një urë
mbi lumin Vardar –
 aq të errët
 sa kjo mbrëmje dimri.*

*Erdhëm,
fantazma,
nga një vënd që s'është tjetër. Do të përkujtonim
një vrasje të njeriut.
 Dhe gjuha e tij
 kërcënohet të vritet.*

*Lumi Vardar
ecën nëpër shtete
që s'flasin njëri me tjetrin,
veç grinden si të marrët.*

Urat kurrë s'do të jenë absurde!

*Në u kthefshin në skelete
urat e vendeve dridhës
do mbushen
me mishin e Ballkanit të pajtuar
si brigjet plot me lotë,
si me legjendat e veta.*

Gostivar, 17.II.93

PARADOKSE KOHE

*Ju u ngritët atëherë për Lirinë,
Luftuat dhe u vratë dhe
Krijuat për ne një tjetër kohë
Që s'na lë të guxojmë
As të vritemi për Lirinë.*

BURIMET

**Po kërkoni burimet
e Vardarit dimëror dhe
gjetëm gëzime fëmijësh
shqiptarë. Mbi borë rrëshqisnin
dhe binin në gropa**

fjalish të huaja.

**Gjetëm
burimet më të lashta të jetës
që rrjedh e rrjedh
nën ura të mëdha ngjarjesh të gurta
dhe ikën lumi tek një det
në bregun e të cilit fillojnë**

legjendat e botës.

Gostivar, 19.II.93

NË SHKUPIN E BUKUR

*Pirgje bore
në rrugët e bukura të Shkupit
si varre të bardhë*

që do të shkrihen.

*Shumë vdekje
kanë humbur këtu
e njerëzit mbajnë mend një tërmet*

të madh që

*mblodhi botën.
Thonë dhe për një gjarpër:
hëngri gruan
e pashait
 në ditën e parë
 të banjave mesjetare. Dhe ai
i mbylli i zemëruar. Sot*

*brenda atyre mureve
është galeria e piktorëve... dhe hutimi
mes grataçieleve*

si ferexhe e harruar.

*Gratë e vizatuara ose arti
aty janë lakuriq
si në banjë
mes avujve të frymëzimit*

dalldisës

*gjithmonë të kërcënuara nga helmi
i atyre që zvarriten*

përtej strofllave të gjarpërinjve.

Shkup, 18.II.93

NË SHTËPINË E VOJSAVËS

*Ndërsa ngjiteshim
nëpër rrugën e bardhë
(me borën si shpirt i hapur)
për të shkuar
në shtëpinë e Vojsavës
të gjithë nga pak
u shndërruam
në Skënderbej...*

Gradec, 17.2.93

LULET E DHURUARA

Dhe shqiptarët
dinë të dhurojnë lule.
A nuk u ngjajnë plagëve të mëdha

Tulipanët-mbështjellë me letër transparente

të gëzimit?
si ndjenjat.

Ne po iknim
përmes dhunës e britmave.
Policët kishin mburoja. Gurët
vinin që nga lashtësitë. Vetëm lulet
dënim të ruanim.
Me to e kaluam kufirin

siç kalohet vetvetja.

Dhe nëse do na pyesni
ç'pamë? Lufta a ishte afër?
Lulet do ju vëmë përballë,
le të flasin ato,

të pagojat.

Një shkrimtar na i dhuroi,
...apo varri i tij...?

Gjatë kthimit, shkurt '93

shtëpia ime e vogël sa zemra Prizren –
Dhe shkallët aty, proverbat, karriget, dyert, ngjarjet
ringjallen e bëhen kuaj dhe
ikim të gjithë karvan
të përsërisim „mes vedi“ Betejën e Kosovës.

Ç'endet ashtu nëpër qiellin
një shotë apo shalli i Presidentit

e trazuar të Ballkanit

apo shpirti i atij që vrau demonin
e stepave të Azisë?

... sa herë flas me vëllezërit e mi... Kosova...

Lushnjë, 12.VI.94

DËSHIRË

*T'i shqyejmë
kufijtë e shteteve*

*si brinjët
e drunjta të Kalit
të Trojës.*

*Ç'tufan shpirtërash
po ngrihet!...*

*BALADAT
E
PARAVDEKJES
DHE
TË
PASVDEKJES*

DIELLI I DYTË

*Shumë gjak
është derdhur mbi këtë botë,
por akoma s'e kemi krijuar diellin e gjakut.*

*Dëgjo, miku im,
këto fjalë që dridhen:
një diell i dytë do të lindë
nga gjaku ynë
në formën e zemrës.*

Poezi e viteve '70-të, për të cilat u dënua autori me 10 vjet burg. Thirrja për një diell të dytë në aktakuzë u „zbërthye“ si thirrje për një sistem tjetër, sepse atëherë ishte „dielli i socializmit“.

SFINKSI

*I tmerrshmi sfinks me krifa muzgu
qëndron i zymtë mbi shkretëtirën.
Madhështia e tij e rëndë prej guri
e bëri, ah, të palëvizshëm!*

*Luanët bredhin nëpër pyje
në shpella ere dhe në shira,
por sfinksin nën rërë yjesh
e torturon madhështia.*

*Mishin pa fund të skllëvërve
e bënë kthetra sfinksesh pompozë.
Shkretëtira tund në apogje
të tmerrshmen madhësinë e kotë.*

Në aktakuzën e autorit kjo poezi u cilësua si alegori për Partinë dhe udhëheqësin e saj, diktatorin e kuq E.H.

MACJA DHE MACJA E PASQYRËS

*Macet nuk kanë të shtuna,
Megjithatë të shtunën në tavernë bujti një mace.
Si delikatesa kurajoze e fjalës „të dua“
U hodh mbi dritare.*

*Ishte e uritur dhe ne i dhamë të hajë
me atë pjatën metaforë në formën e zemrës.
Macja është dobësia pa faj
e tigrin të masakruar dialektikisht dhe egër.*

*Vazhdonin të pinin dhe humoristi i së shtunës
U uroi fat gjithë maceve të kohrave.
Paranoja e gjarpërinjtë e xhunglës
Turbull xixëlloi mbi kaosin e gotave.*

*Befas macja vajti tek pasqyra e banakut
dhe pa një tjetër mace – sozinë e saj
U gëzua, je si tigri me gjahun,
por si vëllai që i gëzohet vëllait.*

*Zgjati putrat e buta tërë sens lëndues
dhe putrat e buta zgjati macja e pasqyrës*

Oh, ç'zhgënjim provokues,
i hapur dhe fyerës!

Jo, ajo s'qenkësh mace, por gënjeshtër
që tallet me adhurimin e maceve...
Sa herë na kanë dalë miq në jetë
të mirë vetëm në pasqyrat e fjalëve.

Dhe na kanë lënë... kanë ikur... mëshirues
e idesë fikse: jeta përmbysset mbi ujra!
Prandaj unë e shpall veten demaskues
i rrethanave që thyhen si pasqyra.

Mallkuar qoftë ai lloj qytetërimi
që s'nderon të vërtetën, liritë e saj!
Përndryshe macja të ribëhet tigri
të keqen me kthetra ta çajë!

* * *

Dhe yjet vdesin
Po në qiell s'ka varre.

Udhëtojnë dritat
e yjeve të vdekur
me ato të të gjallëve.

PRAPA GJËRAVE

*Pas recetave të mjekëve-
gjithë ai vend i bardhë ku mund të shkruhet
diçka për shëndetin.*

*Pas biletave të udhëtimit
mund të fiksosh një mbresë.
Mbi kapakun e fundit të librit*

vazhdo një ide.

*Në anën tjetër të murit
ka ndonjë afresk?*

*Përtej malit kullosin kuajt... në barkun e kalit
kush u fut për të pushtuar qytete ëndrrash?*

*Pas qafës së gruas
varet dhe një gjerdan tjetër*

puthjes.

*Pas pushimeve ke qejf të shtosh një ditë tjetër pushimi
si një varkë.*

*Gjithmonë mund të shtosh një rrahje tjetër zemre
nëpër yje.*

*Zjarrit
dhe një tjetër është të Prometeut*

hidhja.

Fletë të pa shkruara ranë nga pemët.

(Pas telegrameve të vdekjes shkruaj.

shkruaj emra fëmijësh).

Gjithë këto vende bosh për poezinë

edhe brenda lëkurës tënde. (Kujto papiruset.)

Një autograf kërkoi kalimtarit

të ta hedhë

në skaj të ditës.

BRIRËT E DRERIT

*Ç'është kjo kurorë brirësh? Kapriço e Bukurisë
mbi drerin e frymëzimit që vrapon pyjeve.
Ja, ai kthen kokën, por brirët të gjithë
s'ja nxënë dot kornizat e peizazheve.*

*Dhe ikën krojeve, vetveten të pijë.
Mbi bar nën retë shpall frikën e artë.
Brirët ia thyejnë degët pa mëshirë,
ia kapin, copëtojnë, ai vrapon prapë.*

*Dita merr frymë me gojën e drerit-
princit të pyllit që veç rob e duam.
Nga kurora e bukurisë (i) vjen vdekja ndonjëherë
dhe pastaj nga ajo, e poshtra, pushka.*

Këtë poezi diktatura e konsideroi provokim e aluzion për
realitetin e saj.

ABAZHURI

Ty të pëlqen të më dhurosh
një abazhur

në mesnatën e mendimeve.

Që tani ai ka marrë formën elegante

të qafës tënde të bukur, të kokës

që kthehet dhe përkulet

për të ndriçuar duart e mia të pabotuara,

mua të gjithin që jam krah i jetës

(Bashkë me ty bëhemi dy krahë të jetës). Dëshirat
të m'i mbushë me dritë të butë

po të gjallë

fytyra jote.

* * *

Kur njeriu gënjeu për herë të parë
e besuan. Ishte gënjeshtër e parë në botë.
Dhe që nga ajo ditë

nuk besohen të Vërtetat.

Tiranë, 20.IV.'94

BUZËT ME GJAK

*Plaga e hapur
e gladiatorit
gurgullon fundin e jetës...*

*Brohërimat rreth e rrotull shkallëve
e mbushën qiellin me tigra të turbullt.*

*Duke shtyrë anash me duar entuziazmin
Pleqtë e shquar futen në arenë gjithë dinjitet.*

*Të ndarë nëpër galeri
Bien më gjunjë*

*mbi kufomat
akoma të nxehta të rinisë. Vënë buzët e fishkura
mbi burimet e freskëta të plagëve
dhe thëthijnë të babëzitur gjak, gjak, gjak
që t'u zgjatet jeta – kështu
besojnë.*

*Gjaku i ri prej dielli
futet nëpër damarë të fëlliqur
si kanalet e urjave të zeza*

dhe kështu braktiset Zemra e Atdheut.

Lushnjë, 1987

NJË ÇËSHTJE E ERRËT NË JETËN E MOJSI GOLEMIT

Kur isha fëmijë,
babanë tim dhe Skënderbeun
kam adhuruar më shumë nga gjithë burrat e botës
Dhe të gjitha vetëtimat
Më dukeshin si vingëllima të shpatës së heroit.

Çdo vit në shkollë do mësonim
për vdekjen e Skënderbeut
Dhe unë do qaja, kur të tjerët dilnin,
i fshehur tek dera.
Ashtu si kali i tij që s'pranoi më zotëri tjetër
dhe unë s'pranoja më të mësoja gjëra të tjera.

E urreja Mojsi Golemin që na tradhëtoi,
Tradhëtinë unë s'do ja falja kurrë.
Tokë mëmë, atë që në një rrugë të tillë do të shkojë,
Lëre fëmijë, mos e rrit,

ç'e bën kot burrë!
Vonë, shumë vonë, s'e di ku dëgjova, në ç'legjendë
që tradhëtia e Gjeneralit ishte e sajuar: plan, plan!
Atë e paskësh nisur vetë Skënderbeu,
ja ashtu me kryet-skile e trupin luan.

Të mbetesh vetëm, mes të huajve, sulltanit
dorën t'i puthësh,

të përsëritësh thëniet e tij idiote gjoja si mençuri.
Të hash me frikë se mos helmi vdekjeprurës
është në sherbetin e ëmbël
në kupat e florinjta.

Sa më larg haremeve, se
i raportojnë prostitutat dhe psherëtimat dhe puthjet.

Që nga çadra ushtarake deri tek gjysmë hëna qiejve
Hija e tij enigmatike projektonte humbjet.

Ta ruash atdheun brenda

nën përkrenare!

Dhe ti kur të mos jesh, ideali të jetë!

Po e ardhmja merret veç

me ato që duken, si me malet,

Ku ta gjesh, qysh ta spjegosh

një pikëz loti të fshehtë?

E dha jetën Mojsiu si një shigjetë që e hedhim

kuturu nëpër luftëra

duke sakrifikuar në shekuj

diçka më të shtrenjtë akoma:

emrin e tij.

Janë vënë gabim statuja, janë hequr statuja

por të lutem, ndreqe këtë gabim, moj histori!

Gjeneral, ç'torturë e madhe për kohën

pas vdekjes tënde

e cila është pjesa më e rëndësishme për heronjtë.

Prindërit si koha diçka kanë kuptuar,

ja ashtu me hamendje,

që emrin „Mojsi“ vënë tek djemtë edhe sot.

Kur u dënua autori, në aktakuzë pati dhe këtë poezi „si një
shtrembërim të realitetit historik me qëllim që t'u dalë në
mbrojtje tradhtive që zbulonte dhe ndëshkonte P.P.SH.“

(Viti 1979)

TI DHE VDEKJA

*Ty të dua të parën, pastaj dua vdekjen,
sepse ajo më do më shumë kur ti largohesh.
Ulet përballë meje,
mpreh kosën.
Fjalë të mençura i themi njëri-tjetrit
ashtu siç duhet të jenë fjalët e fundit.*

*Po troket dera
„Erdhi Ajo...“ thotë vdekja „Atëherë unë po iki“
„Po“, i them unë i hutuar ndryshe.
Buzëqeshja jote,
që pakëz t'i zbulon dhëmbët –
më e shkëlqyer se presa
e kokës së vdekjes,
Shkëlqen, shkëlqen. Përqafohemi.*

*Rrëzohemi mbi dysheme. Se ç'është
një britmë dërrasash, sikur çahet e braktiset
një arkivol.
Dashuria ngrihet që s'vdes as përkohësisht.*

A JANË BËRË MË TË MIRË VRASËSIT TANË?

*A janë bërë më të mirë vrasësit tanë?
S'e kam fjalën a dinë të vrasin më mirë,*

*tani që janë bërë më të pasur e
merren me tregti jashtë shtetit, jashhtë fatit.
Ushqejnë macet, qenin e zi. I përkëdhelin
sikur qetësojnë një mëkat të harruar.*

Herë pas here çezmat e tyre rrjedhin gjak
e kur dëgjoen trokitje,
seç kanë një frikë të papërcaktuar
i çojnë gratë të hapin derën. (Gjithmonë ato kanë
prirë).
(Si flakë e shuar pishtarësh në korridoret e errët).

A janë bërë më të mirë vrasësit tanë
se të vrarët e tyre s'dinë të bëjnë asgjë,
as të edukojnë.

Bruksel, 18.III.'94

PSALM

Ti je gjuhëzuar
para një muri

që s'është i thertoresh,
as i tempullit dhe
po rrëfesh. I sinqertë
nga e keqja.

Rrjedh zëri yt
i dëshpëruar. Dhe
muri lëviz. Të vjen rrotull
si një valle.

Dhe ti në mes të mureve.
Ngrihesh. Fshin dheun nga
gjuhët

Bien copa mëkati,
e dot nuk del nga qelia.

Rrëfimi yt
më fatkëmb se muret. Po
Zoti të shpëtoftë! Mos qofsh
i dënuar me lumturinë e dikurshme!
Amin.

PIRGU I MASKAVE MBAROI

Ranë
maskat nga fytyrat,
ranë dhe dolën pjesë kafkash të zbrazëta,
copa nofullash të urrejtes,
dhëmbë të liq, ranë maskat njëherësh
duke bërë zhurmën e gjallë
si të zogjve të vrarë
nga pushkët e gjahtarëve.
Pamë rrëke gjaku,
rrëke djersësh të kimit,
në pjesë fytyrash nudo
dhe maskat
mbushën sheshet
si rrënojat e një panteoni të rremë.
Dhe fytyrat kishin ftohtë
s'u rrihej fytyrave,
u binte të fikët i verdhë,
mortor,
s'e duronin dot lirinë,
ishin pa punë
para pargut të madh
të maskave.
Dhe u vërsulën
kthetrat,

kërkonin maskën

*që u duhej pas këtij tërmeti të butë
që s'të tremb,*

*një maskë miqësie,
maskë autoriteti*

*maskë martiri,
të persekutuari,
maska satiri
indiferenti,
maskë të devotshmi,
maskë poeti,
u mbuluan vrimat*

*u mbushën nofullat e urrejtjes,
sytë e ëmbëlsuar
si filxhanët e kafeve*

vanitoze të kafkave,

dhe pingu i maskave

kur u hidhet sheqer

mbaroi

*rruga u hap.
Njerëz, mund të kaloni
sërish.
Mund ta takoni tjetrin,
por kurrë veten tuaj!*

Lushnjë, afër mesnatës, 23.IV.'94

JANË ZBUKURUAR PLEHRAT

Janë zbukuruar plehrat në atdheun tim,
s'janë vetëm lëkura patatesh,
qepësh e gazetash të hedhura
apo këpucë të kalbura,
apo mace të ngordhura.

Janë shtuar plehrat dhe janë zbukuruar
ngjyra-ngjyra si fundi i një ëndrre në mëngjes,
letra çokollatash vezulluese,

ambalazhe gjë a gjëzash,
fotografi lakuriq artistësh të ndaluar,
kuti të bukura pijesh të jashtëme,
plehra të shtrenjta: një kasetë, gjysmë manjetofoni,
skelet veture.

Ja ca furça dhëmbësh

si picirukë përrallash
që kanë vdekur.

Pirgje me plehra, kapakët e shqyer të veprave
të diktatorit,

fotografitë e tij të qeshura dhe pis.
Kalojmë anash plehrave, mespërmes plehrave,
plehra në kujtesë, në biseda, në karrierë
dhë plehrat ndonjëherë janë më pak të shëmtuara,
të dëmshme më pak.

QENTË E SHYTPUR NË RRUGË

*Qentë e vrarë në rrugë,
natën*

*ose herët
kur mëngjesi i ngjanë një loti dridhës,
të shtypur nga makinat*

që janë shtuar,

apo janë shtuar qentë?

*Ç'i hutoi?
Dritat e befta? Zhurmat?
Qentë vrasin veten?
Pafajsitë e pakujdesshme
gjithmonë e mbushin rrugën*

me kufomat e tyre

që s'protestojnë as të vdekura.

Rrogozhinë, 23.9.93

ELEGJI PËR ELEGJITË QË S'DUKEN

Ty të ka marrë malli
për robërinë time të dikurshme,
s'të kujtohet ngrohtësia e duarve të mia të vrara,
por prangat.
Nuk e di pse të duhet keqardhja jote
ndaj vetes time të dikurshme,
ndjeheshe ti më i sigurt, më
i guximshëm. Të shijonte përditshmëria jote
e mërzitshme si cigaret
që t'i jepnin,
si një kafe dëshpërimesh të të tjerëve,
një gotë konjak braktisjesh në të verdhë të fortë.
E siguria ime e tanishme
të jep pasiguri.
Mbase buzëqeshja ime është më e varfër,
se plagët e mia
që ti i lëvizje si dekor plot me yje
për profilin tënd.
Dhe mua më vjen keq që agimi i zbardhi plagët
e mia se më ka marrë malli
për dashurinë tënde të vëmendshme
pas hekurave të burgut të harresës. O Zot!
Mëshirë! Në se globi rrotullohet, jo fytyrat,
jo anën e tyre të pasme plot hije
si flokë të qullur
nga ankthet.

LIQENET E LURËS

Të udhëtosh për në Liqenet e Lurës
të duket sikur kërkon një dashuri të harruar
apo të pagjetur akoma.
Si buzëqeshja mbi buzë ndjehesha rrugës,
Kërkoja, kërkoja....

Papritur m'u shfaq një nga Liqenet, kaq pranë
sa isha i detyruar të klithja nga habia?
klithma e gëzimit tim si peshk i artë
u zhyt nëpër kaltërsira.

Liqenet e tjerë ku janë? që t'mos humbja udhën
thyeja në pyll degë ndjenjash, krisnin krra-u-u!
Po ç'i bashkon ato që me duar vetë i këputëm
e ç'kthim na kthen tek ajo
që lëmë? (...iku dhe qau...).

I gjeta liqenet – vajza të kulluara, lakuriqe,
që u vinte turp prej hireve të tyre
dhe vraponin për t'u fshehur pas çdo pishë
nën stërkalat mahnitëse të yjeve.

Por a do të ikja dot? Liqenet
do t'më ndiqnin nga afër
kur të kisha ndonjë shqetësim, i tradhëtuar kur të
isha.

Aty do të prehesha si një Narcis i kaltër,
i shtangur gjithë dritë si mesdita.

PËRKRENARJA E GJERGJ KASTRIOTIT

*Ka më shumë se 500 vjet
që udhëtoj
për të mbërritur
te kjo përkrenare –*

*me një dhi të florinjtë përsipër;
fluturuese,
që u hidhet qiejve.
Mbi brirë ka akoma copëra yjesh,*

*shirita ylberësh.
Poshtë saj ka diçka nga toka e errët. Ja,
reliefet e fatit, gunga të metalta – nyje ngjarjesh
dhe prapë terr.*

*Ka më shumë se 500 vjet që udhëtoj.
kalova mes betejave si mbi kufoma. Lashë pas
kështjellat. Ç'male që na vodhën
si sëndyqe karvanesh në Ballkan:*

*Ujvarat rrëzohen –
valle vajzash*

*që hidheshin humnerave.
Gjithmonë në atdheun tim ulet nata,
ja si kjo përkrenare,*

që unë e shoh i magjepsur.
Bie më gjunjë.
Xhamat si koha s'më lënë ta prek.
Polen fluturash aty –

gjurmët e gishtave të poetëve.

Dëgjoj këngën e tyre si kori i burrave
në tragjeditë e lashta.

Dhia e praruar më njohu,
më ndjell me sy.
Afrohem drejt saj dhe bleroj
si livadhet e atdheut.

Gjithmonë kjo dhi kullot brenda meje.
Dhe shpesh herë
brirët e saj kanë dalë

mbi kokën time.

Hutohem. Flas përçart.
Ç'ëndërron përkrenare

e ikur kaq larg? Cilin vallë?

Përveçse kryet e popullit!
Po shpata e tët zoti

ku është?

Mbase mjaft goditëm. Ti
na duhesh më shumë sot,
o Përkrenare,

hijerëndë
dhe e çlirët
që vazhdimisht vërtitesh
dhe ulesh mbi atdhe... si mëngjesi.

Vienë, 30.XII.'91

*KOHË
E
BURGOSUR*

* * *

Zgjohuni shpejt, shpejt, shpejt! (Policët me shkopinj gome thyejnë ëndërrat tona si vazo të nëndheshme, antike dhe sytë tanë – kokrra arre të rëna na i shkelin me këmbë).

Në rresht shpejt! (dhe ne e humbim vetveten njëri pas tjetrit).

Shpejt në punë! (marrosen trupat në një guvë nën dritën e kandilit si gjuhë e djallit. Dridhen e spërdridhen gjymtyrët nën ritet e mallkimit. Dhe qanë puna me lotët e djersës. Ulërin e heshtur. Mushkëritë të sëmura me gjak ngjyrë bakri.)
Shpejt dilni!

Shpejt në rresht! Ne dhe të vdekurit tanë, që na mbajnë për krahu që të mos biem. (Policët na kontrollojnë. Fusin duart tek xhepat, këpucët, tek kapelja. S'dinë të hyjnë në kokat tona, tek shpirti.)
Shpejt hani bukë! (në të vërtetë ato pjata të palara na hanë neve si gojë të metalta qikllopësh).
Mblidhuni shpejt. Dhe ne lexojmë libra të diktatorit.

*Me zë të lartë si Ai. Si breshëritë e plumbave dhe
rivriten të pushkatuarit.*

*Në gjumë shpejt! Mbyllni sytë! S'lejohet të shihni
ëndrra!*

*(po ato vijnë, ilegale. Bien në fund të gjumit
si vazot e nëndheshme, antike. Që presin të ardhmen
t'i çmojë...)*

Shpejt! Ra çanga!

*Ra koka e shekullit. I bien me hekur. Fort, prapë,
përsëri, sërish. Shpejt! Shpejt! Shpejt. Ulërima.
Lehje. Flasin qentë, lehin policët. Shpejt! Vetëm në
humnera rrëzohesh aq shpejt!*

CIGARE BURGU

*Grise një copë gazetë
vure pak duhan
të mbledhur nga bishtat e flakur
dhe drodhe një cigare*

*Lajmet
t'u futën në mushkëri
si ty i hidhur*

dhe atdheu kollitet i sëmurë.

Spaç, dimër, 1982

MBI NJË FOTOGRAFI SHKRUAJ LUTJEN

Mbi portretin tënd shkruaj një lutje Zotit.

Balli i shndërroi fjalët në dritë mëngjesi.

*Dy epitetet e vetullave
dhe sytë të mëdhenj, sugjestionues,
që unë të besoj se gjithë penat e botës
mërmëritin lutjen blu
të syve të tu.*

*Te buzët
ngjallen fjalët e mia (si puthjet)
dhe thonë të vërtetën.*

Ja lutja – liqen i vogël, dallgëzon

*dhe fytyra jote – mozaik
i gjallë nën ujë.*

Korrik, 1986

MALET RRETH E RROTULL

*Male
male
gjithmonë male
si piramida mbi shkretëtirën*

e shpirtit të popullit.

*Dhe brenda tyre,
tek të gjitha
dergjet mumja e diktatorit.*

*Prandaj dhe sipër maleve
pemët rriten të shtrembëra*

*nga frika dhe mundimi
si njerëzit.*

GJETHE BURGU

*Mbi një gjethe të blertë
digjej një bisht cigare. E kishte flakur
mes luleve ndonjë i hutuar, sigurisht.*

*Dhe unë mendoj për të burgosurin që e hoqi:
e si mund të jetë ai armik?*

Qafë-Bari 1985

PA TY

Kaq kohë pa ty
dhe koha ngeci si mjegull nëpër kallamat
e bregut të braktisjes.

Kaq kohë pa ty
dhe pemët u bënë të egra, frutat të hidhura,
gjithë gjemba.

Kaq kohë pa ty
dhe yjet e verës u bënë pluhur i ngritur nga vrapi
im i çmendur, megjithëse rrija në vend,
batall.

Kaq kohë pa ty,
nuk të harrova, por më s'të njoh dot, fytyra m'u
mbush
me qime, më dolën brirë dhe kthetra.

Kaq kohë pa ty,
as ti s'më njeh më. Do kesh frikë nga unë...

Mbase do më njohësh nga lotët.

ÇIZMET E REJA

*Na dhanë çizme të reja
dhe rrugët janë në burg.*

*Çizme të reja.
...që t'i njohim,
u gdhendim emrat tanë nëpër thembra,
me një thikëz të vogël, ilegale
si ironia në bisedat me policët.*

*Emrat tanë
që kanë rënë poshtë...ku?...në baltë?
apo në ballin e tokës?*

*Emrat tanë
nëpër thembrat e kohës
si mamuze kalorësish..*

*Në ije shpojme botën si një kalë
me emrat.*

1983

THYERJE

*Unë nuk di më
Si futet dora brenda nëpër flokët e dashurisë.
Nga përkëdheljet a krijohet vetvetiu
unaza e fejesës
në njërin nga gishtat?*

*Kam harruar të kujtoj,
Edhe të harroj kam harruar,*

*Tani di si thyhet krahu vetë:
vendoset mbi një dërrasë,
lidhet me një rrobë si një skllav i tradhëtuar.
E di sa i rëndë duhet të jetë guri
(sa bota!)*

*Dhe i biet krahut fort. Është degë peme
që s'të dhemb, ka hyrë, nga kopshti
i fqinjit krahu yt. Dhe jeta jote s'është e jotja.
Kërciti. U thye. Mermer i statujave antike.*

Apollon. Laokoont.

*Gjarpërinj. Errësirë. S'do punosh më me lopatë.
Invalid i burgosur.*

... nga që s'thyejmë dot prangat...

MBASDITET ZOGJVDEKURA

Kam një copë bukë,
por këtu s'ka zogj
që t'u hedh thërrimet.
I vetëm, i mbështjellë me kapotë,
shëtis në një oborr krimesh.

Në telat me gjemba ka ngecur dielli
si kapela e atij të burgosurit
që e vrau galeria.
Ç'janë këta krahë fluidë, prej qielli
që mbijnë si dëshirat pas supeve

të mia?

Aty-këtu rrëmuja e gjorë e të burgosurve
si vegimet e çmendura!
Po ku të protestoj për tufat e vjedhura të zogjve
nga foletë e ëndrrave?

Në kamp mbasditja është një gjë e kotë,
një boshllëk si kafkë.
Ja, ato copat e bukës
për zogjtë
po i mbledh dora e uritur e
një Krishti plak.

FALEMINDERIT, YLBER!

*Derdhi shiu
gjithë lotët e atyre që janë ndarë.
Po ne e kishim harruar ylberin.*

*Ja tek doli
nga kodra matanë.
Kapërcen telat me gjemba
dhe u fut në kamp
si një kaprolle malli.*

*U mblodhëm
që ta shohim bashkë.
Faleminderit
ty, mrekulli,
që na lidhe me botën jashtë.*

1082

* * *

*Zjarri
dhe përballë tij – unë.*

Pas meje – fantazma e nënës,

Ngrohja duart nëpër flakë.

*Nëna
nëpër flokët e mi
ngrohte duart.*

*Po tani
që atdheu është i qethur
me kryet prej akulli?*

DHE PO PRES, LIRI

*Jam kthyer me fytyrë andej nga duhet të vish ti
dhe po pres...*

*Rrugën e kam kapur me dy duart
si një litar që e tërheqim
nga një pus harrese*

*Dhe të nxjerr ty
të mbytur*

Jo, s'ke vdekur!

Frymën time me buzë e fus në buzët e tua.

Ngjallu dhe folmë...

20.2.85

TË MBLEDHËSH DRITË

*Me ligj
e ndaluar është të qash,
por unë qaj.
Qaj dhe nga gëzimi që akoma di të qaj.
Me duart e vrara mbledh lotët e mi.
Të pastër janë si drita e ditës.
Dhe sytë e tu ashtu janë. Gjithë
sytë e dashurive.
Ka vite që s'i shoh
sytë e tu. As të mitë.
Por ata janë. Sytë e tu
a nuk janë dhe të mitë. E tërë koka
ime është e rrethuar
me sytë e dashurive
si me një kurorë perlash të gjalla.*

*Jam rob
dhe mbret.
Vazhdimisht thyej rreze
me përizmat e xhamtë të kurorës time,
koka më dhemb
dhe do të vdes prej diellit.*

NGA
SHTËPIA
E
HAJNRIH
BËLLIT
NË
PARLAMENTIN
EVROPIAN

..

MESNATA NË SHTËPINË E HAJNRIH BËLLIT

Mesnatat e mençura
T'i pres, më pëlqen,
Ardhja tjetër e ditës
Kur të zgjuar të gjen,

Abazhuri të ofron
një kokë tjetër intime,
Ç'i ngjit ashtu shkallët?
Është mesnata ime.

Megjithëse je larg
në një tjetër atdhe,
Yjet me thua
trokasin xhamave.

Vazhdimisht dynden
me dritat e Këllnit.
Mos është shpirti gjallë
i Hajnrih Bëllit?

*Xhaket'e tij varur
pret ta veshë prapë.
Jeton një çek-këtu
(poet, pa atë „-slovak“),*

*Kinezë të burgosur,
piktori bullgar,
tek dramat e boshnjakes,
Befas bie zjarr.*

*Rrëke prej drite
(në mesnatën e secilit).
Në murin përballë
Hija e Sollzhenicinit*

*Larg kthetrave të ngrira
të natës që na vrau
dhembja ime mëmërit
në Heinrich Bëll-Haus*

Langebroidch, 14.4.93

QIEJT GJERMANË

*Qiejt gjermanë, aq shumë tronditës,
Sikur s'janë qiej, por histori.
Fantoma reshë, betejë e përmbysur,
ç'rrjedh ashtu vallë, ankth apo shi?*

*Qiej kaq të bukur, jo s'janë qiej,
por kopshte parajse (pas ndonjë humbje).
Hedhin mbi ne degë habie,
petale drite, cicërima, puthje.*

*S'ka si të jetë qiell, kështu kaq i ëndërrt,
nga kryet e nxorëm, e çuam lart.
Ja bluja e syve, pafundësia e zemrës,
ju thashë s'është qiell, ky është art.*

*(Ç)magjepsje avionësh në shpella hëne
dhe flatra engjëjsh yllëzuar në anë.
Mes shpirtrash që enden kësaj mbrëmje,
Pranoni dhe timin, qiej gjermanë.*

Langenbroich, 13.4.93

DYQANI I FLOKËVE

Flokë të bukur, të vërtetë,
varur brenda këtij dyqani të xhamtë,
shiten
dhe unë seç ndjej:

dhembjen e ujvarave të ndërprera,
copëtimin e muzgjeve kaçurrele,
tufa e rrezeve – e këputur,
lidhur me një psherëtimë,
shira të braktisur si një dënesë e largët.

{ Pse i preve flokët e gjatë, e dashur?
Të duheshin para
dhe i shite?
Po aty ishin dhe ledhatimet e duarve të mia
të lumtura.

Kaq herë sytë e mi si dy kapronj
u fshehën në atë kaçube
kur hëna digjej si zemra e tyre e përbashkët.

Ti, zonjë e panjohur,
që do blesh flokë,
mbi supe do të varen dhe rënkimet e mia,
puthjet .

*Si bigudina të nxehta, por të vjedhura,
netët e çthurura përzier me ata flokë dikur.*

*Do shëtisësh rrugëve më e bukur,
kurse flokët do përsërisin
një poezi të mësuar përmendësh
dhe jo tjetër të re, flokët e dëshpëruar.*

*Pse, ka flokë të tillël? – pyes veten unë.
Eja këtu, shikoi këta tufanë të vegjël
nga një vrap i çmendur. Shplodhen të dëshpëruar
flokët.....*

Düren, 24.VI.93

NATË VETËTIMASH

*Po flinim
në katin më të lartë, afër qiellit.*

*Dritaret e mëdha sa vjeshta
ishin të hapuara. Vetëtimat
ndizeshin jashtë*

dhe binin si degë zjarresh –

*kështu më dukej.
U egërsuan më dukej.
U egërsuan vetëtimat.
Si gjarpërinj të çmendur
dilnin nga kaçubat e reve*

dhe sulmonin dritaret.

*Ti kishe frikë. Afroheshe pranë meje.
Më përqafoje. Inkandeshente.*

*Lakuriq –
ndriçoheshim befas*

dhe binim në terr.

*Dhe ne u bëmë vetëtimat të gjalla
në krevatin e madh,
lëkundës, të qiejeve.*

Selanik, 12.XII.93

* * *

1944

1944

1944

1979 1979 1979 1979 1979 1979

1979 1969 1979 1979 1979 1979

1987

1987

1987

1987

1987

1987

1987

1990

1993

*...kohë tragjedish... data të ndryshkura si gozhdat e kryqit të një jete... aty të ringjallesh; martir... që bëhesh njeri duke fshirë me duart e tua dridhëse...
rrëketë e përgjakura
të lotëve të
Kohës!*

Langenbroich, II.V.93

DITËT-KENTUAR

Ditët s'janë plotësisht ditë.

*Paraditja
e kokës së bukur të njeriut
bashkohet me mbasditen e trupit turfullonjës
të kentaurit.*

*Nga ana e lindjes,
në kufi
gurët përgjaken.
Jo nga vërshimi i diellit, por*

i gjakut.

*Potkonjtë sllave
shkelin në eposin tonë sërish. Kurse
nga deti,
në perëndim anijet e bardha
sjellin ushqim dhe për kafshët.
Asnjë shpirt të mos ketë uri.
A e di ti që
Rrugëve të botës
ka tabela me skicën e kaprollit? Të kenë kujdes
veturat, mos i shtypin.
Po një popull të përgjysmuar*

që vritet,

*kush do ta mbrojë?
Vetë dielli a s'është më shumë se një simbol që na
tregon*

Ta duam njëri tjetrin!

Trupit të kentaurit

t'i vihet kryet e kalit.

*Natyrisht, është një traktat miqësie ky i njeriut me
kafshët*

Nuk rrojmë dot pa legjenda.

Por

*Cilët po shëtisin me koka të prera njerëzish,
duke i mbajtur*

prej leshrash.

T'i mbyllim,

t'i mbyllim ata në bodrumet e errëta

të historisë.

Edhe legjendat po ikin të fiksuara.

Langenbrich, 17. V.'93

ATJE KU BASHKOHEN (E JO NDAHEN) TRE SHTETE

Shëtisim më këmbë,
me të qeshura shëtisim
nga ky pyll gjerman
me një diell të blertë të pabesueshëm
në Hollandë, në lartësinë më të madhe – si
një xhentilencë e drojtur natyre. Dhe
befas gjendemi në Belgjikë, mbi barin e butë e të
lartë. vrapues si brirët e kaprojve.

Ti seç më thua. Në Gjermani të del dora.
Tufën e flokëve era ta çon në Belgjikë. Kur më
përqafton
krahu tjetër arrin Hollandën. Pastaj
një herë del zemra, sytë, fjala pastaj,
psherëtimat, puthjet,
njeriu i pa çarë me kufij.
E kanë plagosur kufijtë jetën. Por këtu
pasaportat s'kanë kuptim.
Si gjethe të rëna më duken: dhe ne shkelim
mbi pasaportat
e kalbura të ndarjes së botës.

E shkruar në tre shtete më 24.IV.93

Ç'MË THANË MULLINJTË E ERËS NË RRUGË

*Mirëseerdhe, Don Kishot!–
më dukej sikur thoshin krahëhapur
mullinjtë e erës*

në rrugë.

*Ne jemi të qetë tani,
s' punojmë fare: Dhe s'ngajmë
me gjigandet. Aq më tepër
kur pranë nesh ka grataçiele.
Jemi veç për të zbukuruar peizazhet.*

*Dhe t'ju kujtojmë kohën don kishote
kur na dilni përballë.*

*Ai ishte gjigand. Dhe ta dini,
humbja vjen nga që të vlerësojnë,*

jo se ka ndërruar era.

Nëpër autostradën gjermane, 23.IV.93

RRUGA E ATHINËS

Ditën

*është mish i therur,
varur pafund nga këmbët,
Ndrisni sytë e ngrirë të faunës
mes qerpikëve si shenja zie.
Kaq shumë mish i masakruar
çengelave, në dy anët e rrugës.
Ti shkon mes tyre
si një tiran mes popullit të vet:*

*Hungërijnë,
blegërijnë,
këndon turma e të gjallëve
Ngarkohen makinat me kufoma,
jo ambulancat,
as ato të vdekjes.
Shitet mishi i pafajshëm i natyrës,
mëlçi fushash,
kafshë lumenjsh,
flatra krojesh.
Pikon gjaku i perëndimit të
diellit*

*Vjen nata
dhe sytë e ngrirë bëhen drita,*

*drita të kuqe nëpër rrugicat
me kalldrëm si kafka delesh,
korridore druri të kalbura ankthesh,
prostituta lakuriq që shiten
përsëri mish grek i Penelopave
mish rus, polak, shqiptar
„jasu“ – përshëndesin „2000 dhrahmi
çmimi“*

*në dhomat frejdiane
të mbushura plot me pretendentë
të heshtur si kriminelë të kapur.*

*Shoh hijen time në mur
si hark i Uliksit
tendoset.*

Athinë, dhjetor 1993

* * *

*Në vendet ku s'ka elefantë
ka statuja elefantësh.
Statujat e diktatorëve
janë në vendet e diktaturave.*

Langenbroich, 12.V.93

* * *

*trokasin
misonare të Zotit...*

*dera
s'është e imja
e ata s'kanë dyer
që unë të trokas.*

8. V.93

NOTRE DAME

Ti je vetë
organo dhembje
mu në mes të lumit Sena.

Lundron nëpër dallgë njerëzish.
Tek stolat e kopshtit
është ulur nga një Viktor Hygo i bardhë.

Në dy anët e urës së madhe
plot piktorë
vizatojnë fytyrën e kësaj dite,
buzëqeshjet që i merr era
si lulet.

Ti sheh sytë e tu të zinj, Paris.
Dora e një artisti,
refugjat nga Ballkani,
krijoi ato shtjella magjie
mbi fletën e bardhë
për pak franga, sa për një kafe
në Lagjen Latine.

Kryqet në Notre Dame
ndjehen bosh.
Kanë uri si njerëzit.

Paris, 9.VI.93.

KËSHTJELLA E BASTIJES

*Nuk është më.
Por ajri fryhet pak
tek vendi i kullave të mëdha,
forcohet si mushkëritë.*

*E shkatërrouan burgun e Bastijes. Dhe
dritat këtu çdo natë ndezin fytyrat
e dënuara: blu, të kuqërremta,
të blerta e asgjë.*

*Kurse mbi sheshin e madh,
pranë obeliskut me engjëllin e lirisë,
ka rënë konturi i zi i kështjellës
si lëkurë e tharë kafshe
e mesjetës së vranë.*

Paris, 9.VI.93

* * *

*Lejleku
elegant
si shtegtimet e veta*

*elipsi i fatit
fillon te kjo derë
e mbaron këtu*

*lejleku
ngriu
në mur.*

NJË COPË GUR NGA MURI I BERLINIT

Urrej të ndjek si dhe të prij
Fridrih Niçe

Mos harro
të më sjellësh një copë të vogël guri
nga muri i shembur i Berlinit, miku im i huaj!

Kur ta mbaj në duar, e di, do të dridhen kufijtë
e përgjakur të diktaturave, burgjet e tyre,
do të ndjehen keq piramidat,
do të lëvizë shkretëtira valë-valë e zemërimit,
Do të rrezikohet muri i vjetër kinez
si një rresht pleqsh të lagur në azilin e botës.

Oh, sa frikë kanë tani
nga ky gur i pakët, i dhuruar, që unë
e rrotulloj ndër duar si një copëz planeti
të rënë.
Rrotullohen të vrarët, nën dhé, ata që deshën të
kapërcejnë

muret,
telat me

*gjemba,
vdekjen.*

*U duket sikur po mbaj i dëshpëruar
plagën e tyre të shkukur. Dhe
gurët e varreve pendohen.*

Langenbroich, 12.05.'93

MBJELLJA E VETËTIMAVE

**Shkul
vetëtima nga qielli
dhe i mbjell fushave të jetës.**

**Rriten ato si filiza të njomë zjarresh.
Terrin e mendimeve
mbushni me dritë të beftë
Ju, vetëtimat e mia nëpër tokë!**

Tiranë, 27.7.'94

DUKE UDHËTUAR ME TRENIN PARIS – MOSKË

(impresione)

*Si guxon treni të lë Parisin,
Ç'magjepsje nate e ndjell në Moskë?
Peizazhet si njerëzit puthen, ikin
dhe xhami i ndjenjave mbushet me lotë.*

*Nën shi Luvri, Harku i Triumfit,
Dashuria e Senës gjithë dallgë të vjen pas.
Në skaje kujtimesh mblidhet muzgu
Poetik si kafja në Mon Parnas.*

*S'është treni që gulçon nëpër tunele,
Kufij shtetërorë s'njeh dhembja e madhe.
Oh, sa të bukura kanalet belge,
Aty dridhem unë: kryq, katedrale!*

*Gjermania – përrallë pranvere!
Dhe me gurët njerëzisht miqësohesh.
Ç'është kështu? Demonstratë ere,
Bashkë me Varshavën pse rrebelohesh?*

*Trishtim është prapë kjo toka ruse,
Vetëvrasja e poetëve yjet çeli.
Ç'arriti kështu në Moskën e muzgjeve
Vagonët e ankthit, apo ra Ejfeli?*

12. VI.93

* * *

*Në Luksemburg,
mbi një pedestal,
pashë një revolver të madh,
të bronzte.
Grykën ia kishin lidhur nyje
si bisht qeni.
Tani mund të bisedojmë me botën
pa lehur.*

Rrugës, mars '94

ROBËRIT E LIRË

Ne ishim të lirë,
por të paçliruar.
Flisnim vetëm për diktaturën
në një restorant luksoz, pranë zjarrit
në një kryeqytet të botës.
Tregonim plagët tona
Sikur t'i rrëfenim njëri-tjetrit
gurë të çmuar, diamantë –
dhuruar nga një përbindësh.
Mburrehim me skllavërinë
duke e kritikuar ashpër. Dhe
s'po gjenim kohë të ishim të lirë.
Hijet tona
të zmadhuara prej zjarrit,
dridheshin mbi mozaikun modern
si një rresht i largët njerëzish
me pranga.
Dikur, robër; mos ishim më të lirë?

Bruksel, 18.3.'94

KAFEJA NË PARLAMENTIN EVROPIAN

*Pinë kafe në Parlamentin Evropian
i rrumbullakët filxhani*

*si vendosja e tryezave të Parlamenitit
me 12 yje mbi porcelanin blu –*

*marrë nga qiejt e 12 vendeve
dhe vendosur në formë kurore.*

*(E vë mbi krye, kullon ari mbi ballin tim)
dhe pi kafënë i qetë si një sovran*

pa asnjë shtet,

një copë gëzimi hedh si sheqerin.

*E trazoj me një lugëz të vogël kauçuku
a ndoshta me penën time, Jam i hutuar;*

*...Belgjika me Danimarkën, Spanja, Franca, Greqia
me Italinë e Irlandën, Luksemburgu,*

Vendet e Ulëta, Portugalia, Gjermania, Mbretëria

e Bashkuar...

*Filxhani i madh është mbushur përgjysmë,
mungojnë gjithë ato vende. Më dridhen duart.*

Më derdhet kafeja.

mbi këmishën time të bardhë

si dëshirat.

Në fakt më bien shtetet mbi gjoks

dhe unë forcoj skeletin e brinjëve të mia

të atdhenjta.

Luksemburg, 16.3.'94

SHI I BUKUR, I HUAJ!

*Si ta dalloj shiun e Brukselit
nga të Luksemburgut
të ngjashëm me dy sytë e bukur, pak të vëngër
të një vajze prej ëndrre!*
Si ta dalloj shiun që bie brenda meje?
*Si ta dalloj shiun që bie poshtë xhamave
të trenit?*
*Mos janë stërkalat e liqeneve të vegjël,
trembur nga ndonjë kaproll?*
*Erdha në Luksemburg dhe më tronditi
fundi i këtij emri
sikur treni të kish dalë nga shinat.
Ndoshta ngaqë dhe unë kam dalë nga... burgu.*

15.3.'94

MËRMËRIMA DASHURIE NË BRUKSEL

*Larg, shumë larg nga ty dhe dimri ynë,
këtu në Parlamentin Evropian.*

*pas xhamave të të cilit dallgëzojnë
çatitë e Brukselit si një det jete,
vijnë fjalët e tua të dashurisë.*

Kush i solli? Ne na kontrolluan kur u futëm.

Për eksperiencë vinim, nga Lindja,

*nga diktaturat e rrëzuara
dhe s'dëgjova asgjë, veç mërmërimave të tua.*

Nëse do të diskutoj, këtë do të them:

Fryma e dashurisë

endet nëpër Evropën

pa asnjë shtet të ndaluar.

Bruksel, 14.4.'94

LUXEMBOURG, THE GREEN HEART OF EUROPE

*Zemër e blertë e Evropës,
një e rrahur e jotja
ish dita ime tek Ty.*

*Pastaj, kur ti u mblodhe
për ta çuar gjakun
në të gjitha skajet,*

*Unë mbërriva tek pylli im,
u futa në shpellën time
si një erë.*

dhe po qaja...

* * *

*Një syprinë xhami
mbi flatra të florinjta
mjellmash...*

*por mua një gur i lidhur
pas këmbëve
më tërheq poshtë e më poshtë
drejt atdheut.*

Luksemburg, mbasdite marsi '94

* * *

Dua t'i këndoj dritës

*që hyn nga e çara në fund të derës.
Si vetëtimë e uritur fle mbi pragun e dëshirave.
Është plasaritje e natës ajo,
fillimi i buzëqeshjes pas rënies së një maske,
e gurëve, e dhunës,
të një epoke.*

*Drojtja e dritës poshtë derës – zarf i shumëpritur...
Ti nxiton aty,*

*ulesh që ta marrësh.
Hija jote mbi dysheme si mozaik me gurë të zinj
i Prometeut të lidhur.*

Dua t'i këndoj çlirimit të hijes së njeriut!

Langenbroich, 28.VI.'93

Shënime për autorin

Poeti ynë Visar Zhiti u lind në Durrës më 2.XII.1959, ku i ati, poet e artist, Hekurani, qe internuar nga pushteti komunist. Më parë pati jetuar në Berat e rridhte nga Skrapari. Në poezinë shqipe Hekuran Zhiti është i njohur me poemën tronditëse „Përçafimi i dy kundërshtarëve“, ku kërkon bashkimin e shqiptarëve nën shqiptonjën tonë – kërkesë kjo që do të kishte pasoja për jetën e tij dhe të familjes së tij. U arrestua, u internua dhe u torturua barbarisht. Pasi kaloi fëmijërinë, poeti me familjen vendoset në Lushnjë, për të kërkuar fat më të mirë, por...

Mbasi kryen shkollën e mesme, Visari diplomohet për gjuhë e letërsi në Univerzitetin e Shkodrës. Ishin vitet e „liberalizmit“ kur lufta e klasave do të zbutej disi, por diktatura do të tërbohet sërish e do të ndëshkonte pa mëshirë njerëz e veptra.

Libri i parë poetik i Visar Zhitit u ndalua nga botimi pas Plenumit IV aq të llahtarshëm, e më vonë do të dënohet edhe vetë autori me 10 vjet burg më 1980, me akuzën absurde për këtë libër: „Dekadent dhe armiqësor.“


Burgun e vuan në kazamatet e Spaçit dhe të Qafë-Barit. Pas lirimit punon në fabrikën e tullave në Lushnjë. Me fillimin e proceseve demokratike radhitet ndër të parët në luftën paqësore kundër diktaturës. Inkuadrohet në gazetën e parë opozitare „Rilindja demokratike“. Shkon për specializim në Itali tek gazetatat më të njohura „Corriera della sera“, „Il sole 24 ore“ dhe „Avvenire“. Në Itali merr Çmimin

ndërkombëtar për poezi „Leopardi i lartë“, kurse me tërëzim zë vendin e parë në Konkursin „Rrëfe Zotin tënd“.

Kthehet sërish në gazetën „RD“. Boton librin e parë me poezi „Kujtesa e ajrit“ (1993), i cili merr Çmimin kombëtar, si libri më i mirë i vitit. Për vlerat e kësaj poezie kanë shkruar edhe kritikë amerikanë e italianë. Pastaj emërohet në Shtëpinë Botuese „Naim Frashëri“, ku botohet Dino Buxati, Soresku, Faik Konica e krijues të persekturuar e të ndaluar. Libri i dytë i autori „Hedh një kafkë te këmbët tuaja“ botohet më 1994, në të cilin janë përfshirë edhe mjaft poezi të shkruara fshehtëazi në burgjet e diktaturës komuniste.

Sot Visari ponon në Kuvendin Popullor ku merret me botimet, bibliotekat dhe arkivin.

„Mbjellja e vetëtimave“ është libri i tretë poetik i autorit.



Përmbajtja

***	5
-----	---

Fantazma në një Republikë të re

***	9
Një urë mbi Vardar	10
Paradokse kohe	11
Burimet	12
Në Shkupin e bukur	13
Në shtëpinë e Vojsavës	15
Lulet e dhuruara	16
Profil dheu	17
Dëshirë	19

Baladat e paravdekjes dhe të pasvdekjes

Dielli i dytë	23
Sfinksi	24
Macja dhe macja e pasqyrës	25
Prapa gjërave	27
Brirët e drrerit	29
Abazhuri	30
***	30
Buzët me gjak	31
Një çështje e errët në jetën e Mojsi Golemit	32

Ti dhe vdekja	34
A janë bërë më të mirë vrasësit tanë?	35
Psalm	36
Pirgu i maskave mbaroi	37
Janë zbukuruar plehrat	39
Qentë e shtypur në rrugë	40
Elegji për elegjitë që s'duken	41
Liqenet e Lurës	42
Përkrenarja e Gjergj Kastriotit	43

Kohë e burgosur

***	47
Cigare burgu	49
Mbi një fotografi shkruaj lutjen	50
Malet rreth e rrotull	51
Gjethe burgu	52
Pa ty	53
Çizmet e reja	54
Thyerje	55
Mbasditet zogjvdekura	56
Falemnderit, ylber!	57
***	58
Dhe po pres, Liri	59
Të mbledhësh dritë	60

Nga shtëpia e Hajnrih Bëllit në Parlamentin Evropian

Mesnata në shtëpinë e Hajnrih Bëllit	63
Qiejt gjermanë	65
Vendeve pa emër nëpër Gjermani	66
Dyqani i flokëve	67
Natë vetëtimash	69
***	70
Ditët – kentaur	71
Atje ku bashkohen (e jo ndahen) tre shtete	73
Ç'më thanë mullinjtë e erës në rrugë	74
Rruga e Athinës	75

***	77
***	78
Notre Dame	79
Kështjella e Bastijes	80
***	81
Një copë gur nga Muri i Berlinit	82
Mbjellja e vetëtimave	84
Duke udhëtuar me trenin Paris – Moskë	85
***	86
Robërit e lirë	87
Kafeja në Parlamentin Evropian	88
Shi i bukur, i huaj!	89
Mërmërima dashurie në Bruksel	90
Luxembourg, the green heart of Europe	91
***	92
***	93
Shënime për autorin	95



Libri i parë poetik i Visar Zhitit u ndalua nga botimi pas Plenumit IV aq të llahtarshëm, e më vonë do të dënohet edhe vetë autori me 10 vjet burg më 1980, me akuzën absurde për këtë libër: „Dekadent dhe armiqësor.“